

STATUTI I FIAF
[Fédération Internationale des Archives du Film]

KAPITULLI I - EMRI DHE QËLLIMI

Neni 1

Me 1938 u themelua një Shoqatë e quajtur Federata Ndërkombëtare e Arkivave të Filmit (FIAF) e cila në paragrafet që vijojnë quhet me emrin “Federata”.

Ajo ka për qëllim:

- a) Të favorizojë ruajtjen e pasurisë artistike dhe historike kinematografike dhe të grumbullojë në gjirin e saj gjithë organizatat që merren me këtë qëllim.
- b) Të lehtësojë mbledhjen dhe shkëmbime ndërkombëtare të filmave dhe të dokumentave në lidhje me historinë dhe artin kinematografik, me qëllim që ato të vihen në dispozicion të masave të gjëra.
- c) Të zhvillojë bashkëpunim midis antarëve të saj.
- d) Të ndihmojë zhvillimin e artit dhe të kulturës kinematografike.

Neni 2 - Afati i ekzistencës së Federatës është i pakufizuar.

Neni 3 - Selija e Federatës është e caktuar në Bruksel

KAPITULLI II – ORGANET E VEPRIMIT

Neni 4

Aktiviteti i Federatës zhvillohet me anën e organeve që vijojnë:

- a) një Sekretariat që siguron sidomos mbajtjen e marrëdhënieve midis antarëve, në vështrim të lehtësimit të punimeve të tyre individuale.
- b) të zyrave, institucioneve të kërkimeve, sesioneve krahinore, kinematekave të specializuara, qendrave të qarkullimit të brendshëm, shoqërive të qarkullimit etj.
- c) të kongreseve, konferencave dhe manifestimeve ndërkombëtare (ekspozita dhe ceremoni përkujtimore, etj...)

Federata mund të përdorë gjithashtu të gjitha mjetet dhe organet e tjera të veprimit që nuk numërohen më sipër dhe që konsiderohen të nevojshme nga organet e saj drejtuese.

KAPITULLI III – ANËTARËT

Neni 5

Federata përbehet kryesisht nga kinematekat, arkivat, muzeumet kombëtare të kinemasë, krahinore ose lokale, zyrtare apo shtetërore, gjysëmzyrtare apo private, që i dedikohen historisë ose estetikës së kinemasë dhe që ndodhen në dispozicion të publikut.

Si qëllim të veprimtarisë së tyre, anëtarët e Federatës duhet të kenë:

- a) mbledhjen dhe ruajtjen e filmave dhe të dokumenteve që kanë lidhje me ta;

b) brenda mundësive, shfaqjen e filmave dhe ekspozimin e dokumenteve në mënyrë jo komerciale, për qëllime historike, pedagogjike dhe artistike.

Në gjirin e Federatës nuk mund të pranohen institucionet ose organizatat, cilado që të jenë, që filmat dhe koleksionet e tyre do të përdorin, nën siglën e Arkivës, për qëllime tregëtimi (fitime në favor të administratorëve dhe pjesëmarrësve në këtë institucion ose organizmë).

Neni 6

Numri i kinematekave, arkivave dhe muzeumeve të kinemasë që i përkasin të njëjtit vend dhe që mund të pranohen si anëtare në gjirin e Federatës nuk është i kufizuar.

Anëtarë efektivë dhe të përkohshëm gëzojnë të drejta ekskluzive mbi gjithë tokën e vendit të tyre.

Arkivat e një vendi të vetëm kanë të drejtën të bashkohen vullnetarisht në gjirin e një Federate kombëtare e cila, me këtë rast mund të kërkojë nga Asambleja e Përgjithshme të veprojë si anëtare e Federatës.

Neni 7

Federata përbëhet nga:

- a) anëtarët e përkohshëm
- b) anëtarët efektivë
- c) anëtarët korresponues

Neni 8

Çdo kinematekë që dëshiron të bëhet anëtare efektive e Federatës, në fillim duhet të paraqesë kandidaturën e saj për të fituar cilësinë e anëtares së përkohëshme.

Anëtarët e përkohshëm pranohen prej Asamblesë së Përgjithshme dhe marrin pjesë në të gjitha aktivitetet e Federatës por nuk gëzojnë të drejtën e votimit dhe përfaqësuesit e tyre nuk mund të bëjnë pjesë në gjirin e komitetit drejtues. Ata paguajnë vetëm një pjesë të kuotizacionit që kërkohet nga anëtarët efektivë.

Neni 9

Si anëtarë efektivë mund të pranohen anëtarët e përkohshëm të cilët kanë pasur këtë cilësi të paktën për një vit.

Anëtarët efektivë kanë të drejtën e votimit në Asamblenë e Përgjithshme, ata janë të vetmit që gëzojnë të drejtën të zgjedhin kandidatë në zgjedhje dhe vetëm përfaqësuesit e tyre mund të zgjidhen anëtarë të komitetit drejtues.

Ata detyrohen t'i paguajnë Federatës një kuotizacion vjetor.

Neni 10

Anëtarët korrespondues u përkasin vendeve ku nuk ka anëtarë efektivë ose të përkohshëm. Ata shërbejnë si ndërlihdësa midis këtij vendi dhe Federatës.

Ata marrin pjesë me këtë titull në punimet dhe Asambletë e Federatës dhe mund të konsultohen

prej saj.

Anëtarët e Federatës që dëshirojnë të zhvillojnë një aktivitet në një vend ku ekzistojnë anëtarë korrespondonjës të Federatës e kanë për detyrë ti njoftojnë ata.

Neni 11

Cilësia e anëtarit efektiv ose të përkohshëm humbet në rastin e dorëheqjes, të prishjes së anëtarësisë ose të dëbimit në konditat që vojojnë:

- a) anëtarët e Federatës mund të japin dorëheqje me konditë që të jenë në rregul me kuotizacionet dhe të kenë plotësuar angazhimet e tjera që kanë marrë kundrejt Federatës dhe anëtarëve të saj.
- b) Ç'rregjistrimi i një anëtari mund të vendoset në rast se nuk paguan kuotizacionin për dy vjet. Ky vendim i propozuar nga Komiteti Drejtonjës duhet të aprovohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e 2/3 e anëtarëve të saj efektive që marrin pjesë në këtë Asamble.
- c) Dëbimi i një anëtari mund të vendoset në rast se ai zhvillon aktivitete të dëmshme për Federatën. Vendimi i dëbimit i propozuar nga Komiteti drejtues që vepron me iniciativën e tij, ose me rekomandimin e jurisë së arbitrazhit, duhet të votohen nga Asambleja e Përgjithëshme kur ndodhen të pranishëm 2/3 e anëtarëve efektivë, ose kur ata të kenë derguar përfaqësuesit e tyre dhe me shumicën e 2/3 të anëtarëve efektivë që marrin pjesë në këtë Asamble.

Neni 12

Cilësi e anëtarit mund të pezullohet në rastet që vijojnë:

- a) vendimi i pezullimit merret nga Komiteti drejtues për shkelje të statuteve ose të rregulloreve të Federatës, ose për cdo faj tjetër të rëndë me rekomandimin e jurisë së arbitrazhit. Në rastet e jashtëzakonshme prej Komitetit Drejtues me vetë iniciativën e tij.
- b) Ky vendim i Këshillit drejtues duhet t'i parashtrahet mbledhjes më të afërt të Asamblesë së Përgjithëshme, e cila mund ta pranojë përsëri anëtarin, ose të vërtetojë pezulimin e anëtarësisë së tij për një kohë të caktuar, ose të votojë dëbimin e tij.

KAPITULLI IV - ORGANET DREJTUESE

Neni 13

Organet drejtuese të Federatës janë:

- a) asambleja e përgjithëshme
- b) komiteti drejtues

Neni 14

Asambleja e Përgjithëshme e anëtarëve të Federatës është organi suprem i saj. Në të mund të asistojnë të gjithë anëtarët e Federatës. Anëtarët efektivë mund t'i delegojnë votat e tyre një anëtari tjetër efektiv, por asnjë anëtar nuk mund të votojë për më shumë se dy anëtarë efektivë që mungojnë.

Asambleja e përgjithëshme e zakonshme thirret nga Komiteti Drejtues 1 herë në vit. Thirrja

duhet t'u dërgohet anëtarëve të paktën 2 muaj para mbledhjes së saj. Rendi i ditës së Asamblesë së Përgjithshme caktohet nga Komiteti Drejtues. Viti I punës përfshim periudhën nga një Asamble e Përgjithshme e zakonshme në tjetrën, me përjashtim që përsa i përket financës zbatohet viti kalendarik.

Neni 15

Asambleja e përgjithshme është e vlefshme në rast se janë të pranishëm ose të përfaqësuar të paktën gjysma e anëtarëve efektivë.

Në rast se Brenda një kohe prej 24 orësh pas ores së parashikuar për fillimin e debateve, numuri i duhur i anëtarëve nuk sigurohet, Komiteti Drejtues cakton datën e një Asambleje të re e cila mund të mbliidhet në mënyrë të vlefshme, pavarësisht nga numuri i anëtarëve të pranishëm. Kjo Asamble e Përgjithshme që mbliidhet sipas dispozitave të lart përmendura, mund te diskutojë dhe të marrë të gjitha vendimet e rastit, me përjashtim të atyre që parashikohen nga nenet 11, 12 dhe 29 të statuteve.

Neni 16

Midis të tjerave Asambleja e Përgjithshme ka atributet që vijojnë:

- a) të aprovojë raportet e presidentit, sekretarit të përgjithshëm dhe të arkëtarit dhe të japë udhëzimet e duhura në lidhje me veprimtaritë e ardhëshme të Federatës.
- b) Të aprovojë llogaritë e ushtrimit financiar të mbyllë dhe të ç'ngarkojë nga ushtrimi i tij komitetin e vjetër drejtues.
- c) Të votojë buxhetin e ushtrimit financiar të ardhshëm dhe të caktojë shumën e kuotizacionit vjetor.
- d) Të aprovojë blerjen e pronave të patundëshme të propozuar nga Komiteti Drejtues
- e) Të marrë të gjitha vendimet në lidhje me ndryshimet në statut, me pjesëmarrjen e Federatës në organizata të tjera ndërkombëtare dhe me shpërndarjen e Federatës.
- f) Të aprovojë rregulloret e hartuara nga Komiteti Drejtues.
- g) Të krijojë, të kontrollojë veprimin dhe të shpërndajë zyrat, seksionet krahinore, qendrën e qarkullimit të brendshëm, qendrat e shërbimit të filmave dhe organet e tjera të veprimt të Federatës.
- h) Të pranojë anëtarët e rinj të Federatës
- i) Të aprovojë propozimet në lidhje me heqjen nga radhët, dëbimin ose pezullimin e anëtarësisë së anëtarëve
- j) Të shqytrrojë apelimet kundër vendimeve të jurisë së arbitrazhit
- k) Të zgjedhë Komitetin Drejtues dhe Komisarët e Llogarive
- l) Të japë cilësinë e anëtarit të nderit të Komitetit Drejtues dhe , zakonisht, të vendosë mbi të gjitha çështjet që kanë lidhje me Federatën.

Neni 17

Një Asamble e Përgjithshme e jashtëzakonshme mund të mbliidhet sa herë që është e nevojshme me anën e një vendimi të Komitetit Drejtues ose me kërkesën e të paktën 2/3 të anëtarëve efektivë të Federatës, me një paralajmërim prej të paktën një muaji.

Neni 18

Ç' do anëtar efektiv i Federatës ka të drejtën për një votë në debatet e Asamblesë së Përgjithshme, me përjashtimin që vijon: në rast se shumë anëtarë efektivë i përkasin vetëm një vendi, të gjithë këta anëtarë gëzojnë të drejtën e një vote të vetme, të cilën e ndajnë në mënyrë të barabartë midis tyre, sipas procedurës që përcaktohet nga rregullorja.

KOMITETI DREJTUES

Çdo Asamble e Përgjithshme e akonshme zgjedh një Komitet Drejtues të përbërë nga 11 anëtarë të zakonshëm dhe nga tre anëtarë zëvendës.

Anëtarët e vitit të kluar mund të zgjidhen përsëri. Asambleja në gjirin e Komitetit Drejtues nuk jep të drejtën për asnjë shpërblim. Komiteti Drejtues përbëhet nga 1 kryetar, nga 1 ose më shumë nën kryetarë, nga 1 sekretar i përgjithshëm, nga një nën sekretar i përgjithshëm, nga 1 arkëtar, nga 1 nënarkëtar dhe nga anëtarë të zakonshëm dhe zëvendës.

Në mbledhjen e Komitetit Drejtues marrin pjesë edhe anëtarë të nderit. Federata drejtohet nga Kryetari. Ai zbaton vendimet e Komitetit Drejtues dhe merr të gjitha iniciativat e nevojshme për veprimtarinë e Federatës midis 2 mbledhjeve në Komitetin Drejtues.

Sekretari i Përgjithshëm kontrollon gjithë punën e organeve administrative të Federatës sipas udhëzimeve dhe nën përgjegjësinë e Kryetarit.

Arkëtari është përgjegjës për ushtrimin financiar të Federatës.

Sekretari i përgjithshëm dhe arkëtari veprojnë nën përgjegjësinë e Kryetarit.

Neni 19

Komiteti Drejtues mbledhet në mënyrë të vlefshme në rast se janë të pranishëm 6 anëtarë ose zëvendësuar e tyre.

Neni 20

Midis të tjerave Komiteti Drejtues ka edhe funksionet që vijojnë:

- a) të drejtojnë punën e Federatës midis Asambleve të Përgjithshme
- b) të thërresë dhe të përgatisë rendin e ditës të Asambleve dhe të të gjitha mbledhjeve të Federatës
- c) të zbatojë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme
- d) të caktojë sekretarin ekzekutiv, ta udhëzojë atë dhe të kontrollojë veprimtarinë e tij
- e) të marrë të gjitha vendimet e dobishme, sidomos për ruajtjen e intergritetit të Federatës.

Neni 21

Komiteti Drejtues mbledhet me ftesën e Kryetarit me iniciativën e tij ose me kërkesën e shumicës së anëtarëve të tij. Ai mbledhet të paktën 4 herë në vit.

Neni 22

Federate përfaqësohet nga Kryetari i saj. Në raste të caktuar Kryetari mund t'ia delegojë fuqinë e tij njërit prej nën kryetarëve ose ndonjë anëtarit tjetër të Komitetit Drejtues. Një veprim i tillë bëhet gjithmonë me shkrim.

KAPITULLI V - JURIA E ARBITRAZHIT

Neni 23

Me qëllim që të gjykojë mbi respektimin e statuteve dhe të rregulloreve të Federatës, një juri arbitrazhi krijohet sa herë që paraqitet një ankesë për shkeljen e statuteve dhe rregulloreve. Kjo juri përbëhet nga tre veta që caktohen të përfaqësojnë anëtarët efektive të Federatës sipas përcaktimit të rregullores.

KAPITULLI VI - FINANCAT

Neni 24

Shpenzimet e Federatës mbulohen kryesisht nga kuotizacionet vjetore shuma e të cilave caktohet çdo vit nga Asambleja e përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme mund të kërkojë kontribute të tjera për plotësimin e shpenzimeve ose kuotizacione të veçanta për qëllime të posaçme. Nga ana tjetër Federat mund të marrë subvencione ose dhurata të tjera nga anëtarët e saj ose nga burime të tjera.

Neni 25

Përveç kësaj burimet e të ardhurave të Federatës mund të përbëhen edhe nga:

- a) shumat që ajo mund të marrë si kthim të shpenzimeve nga një palë e tretë për shkak të shërbimeve që janë bërë.
- b) Burimet që mund të sigurohen nga manifestimet që mund të organizohen në përfitimin e saj
- c) Burimet e saj vetjake të krijuara në kuadrin e mjeteve të saj të veprimit.

Neni 26

Çdo vit Asambleja e Përgjithshme zgjedh 2 komisarë të llogarive. Ato kanë për detyrë që të shqyrtojnë llogarinë e arkëtarit dhe të rekomandojnë pranimin e tyre nga Asambleja e Përgjithshme.

KAPITULLI VII - PJESËMARRJA NË NJË ORGANIZATË TJETËR NDËRKOMBËTARE

Neni 27

Pjesëmarrja e Federatës me cilësinë e anëtarit të një organizate tjetër ndërkombëtare nuk mund të vendoset veçse nga një Asamble e Përgjithshme në të cilën duhet të jenë të pranishëm të paktën

gjysma e anëtarëve efektivë ose të përfaqësuar dhe me shumicën e 2/3 të anëtarëve efektivë që marrin pjesë në këtë Asamble.

KAPITULLI VIII – NDRYSHIMET E STATUTIT

Neni 28

Statutet e Federatës mund të ndryshohen vetëm nga Asambleja e Përgjithshme. Kërkesat për ndryshime në statutet e Federatës mund të paraqiten nga çdo anëtar i Federatës dhe duhet të dërgohen sekretaritit të paktën 45 ditë para mbledhjes së përgjithshme. Këto propozime sekretariati duhet t'ua dërgojë gjithë anëtarëve të Federatës me qëllim që ata të marrin të paktën 15 ditë përpara Asamblesë së Përgjithshme. Detyra për t'ia paraqitur Asamblesë të gjitha propozimet për ndryshime të marra nga anëtarët si dhe ato të marra me iniciativën e tij, i përket Komitetit Drejtues.

Për të marrë një vendim mbi ndryshimet në status, Asambleja duhet të sigurojë pjesëmarrjen ose përfaqësimin e të paktën 2/3 e anëtarëve efektivë të Federatës, kurse vendimin duhet të merret me shumicën e 2/3 të anëtarëve efektivë që marrin pjesë në këtë Asamble.

KAPITULLI IX - SHPËRNDARJA

Neni 29

Shpërndarja e Federatës mund të vendoset vetëm nga një Asamble e Përgjithshme e jashtëzakoshme e thirrur posaçërisht për këtë qëllim, me një paralajmërim prej të paktën 3 muaj dhe në të cilën duhet të jenë të pranishëm të paktën 2/3 e anëtarëve që marrin pjesë në këtë Asamble.

Në rast shpërndarjeje vullnetre, Asambleja e Përgjithshme cakton një ose më shumë komisarë të ngarkuar që të procedojnë në likuidimin e pasurive të Federatës, aktivi netto i së cilës do t'i atribuohet një organizate kinematografike ndërkombëtare që ka qëllime të afërta me ato të Federatës.

KAPITULLI X – GJUHËT ZYRTARE

Neni 30

Gjuhët zyrtare të Federatës janë: frëngjishtja, anglishtja, spanjishtja dhe çdo gjuhë tjetër e zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme si gjuhë zyrtare. Për këto statute teksti zyrtar përbëhet nga teksti frëngjisht.

KAPITULLI XI – RREGULLORET

Neni 31

Për të gjitha hollësitat dhe mënyrën e funksionimit dhe në të procedurës që nuk parashikohen në këtë statut duhet tu referohemi rregulloreve të Federatës.

